



FTESE PËR PJESËMARRJE DHE THIRRJE PËR KUMTESA

Konferenca e Parë e Muzeut të Bankës së Shqipërisë

“Paraja dhe bankingu në Shqipëri, nga antikiteti në ditët tona”

Data: 14-15 qershor 2017

Vendi: Banka e Shqipërisë, Tiranë.

Gjuhët e konferencës: shqip dhe anglisht.

Banka e Shqipërisë ka kënaqësinë të njoftojë organizimin e Konferencës së parë të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, e cila do të zhvillohet në datat 14-15 qershor 2017, në selinë e saj qendrore, në Tiranë.

Konferenca do të jetë një veprimtari dyditore që do t'i kushtohet temës: “Paraja dhe bankingu në Shqipëri, nga antikiteti deri në ditët tona” (dita e parë e saj). Ndërsa dita e dytë e kësaj konference do t'i dedikohet rolit edukues të muzeve të bankave qendrore në njohjen e historisë së parisë, bankingut dhe rritjes së kulturës financiare përmes ekspozitave, edukimit dhe inovacionit.

Qëllimi i ditës së parë të konferencës është të mbledhë së bashku historianë, numizmatë, arkeologë, e studiues të historisë monetare e ekonomike, për të prezantuar e diskutuar gjetjet e studimeve të tyre në fushën e prodhimit dhe qarkullimit monetar, historisë ekonomike dhe zhvillimit të bankingut në vendin tonë, nga antikiteti e deri në ditët tona. Aktiviteti do të organizohet në tre sesione të fokusuara përkatësisht në lashtësi, mesjetën deri në shpalljen e pavarësisë dhe në periudhën moderne nga shpallja e pavarësisë deri në ditët tona. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë fton të gjithë studiuesit të aplikojnë me punët e tyre për t'u bërë pjesë e këtij aktiviteti shkencor duke na dërguar abstrakte të kumtesave të propozuara deri më datën 10 prill 2017, ora 17:00.

Temat e propozuara:

- Shkëmbimi paramonetar dhe dëshmi të formave paramonetare të këmbimit në lashtësi
- Prodhimi dhe qarkullimi monetar në Ilirinë e Jugut, shek. V-I p.e.s
- Thesaret që fsheh nëntoka shqiptare, burim i rëndësishëm informacioni për numizmatikën ilire
- Ekonomia, shkëmbimi dhe qarkullimi monetar në shek. IV-XIV, në territoret shqiptare
- Qarkullimi monetar dhe marrëdhëniet tregtare të viseve shqiptare nën Perandorinë Osmane

- Adriatiku: vijë ndarëse dhe urë lidhëse e shkëmbimeve tregtare në prag të Luftës së Parë Botërore
- Përpyekjet e para për krijimin e një banke kombëtare shqiptare dhe emetimi i monedhës së parë shqiptare
- Politika monetare dhe mekanizmi ekonomik gjatë sistemit komunist
- Zhvillimi i bankingut qendror modern, një shtysë për rritjen ekonomike të vendit

Banka e Shqipërisë fton gjithë të interesuarit të shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e kësaj konference, duke dërguar abstrakte të kumtesave të propozuara deri më datën 10 prill 2017, ora 17:00, në adresat:

Muzeu i Bankës së Shqipërisë: muzeu@bankofalbania.org;

Arlinda Koleniço (Departamenti i Kërkimeve): akolenico@bankofalbania.org

Aplikuesit e suksesshëm do të njoftohen brenda datës 17 prill 2017.